

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE

SHTJELLIMI I SFIDAVE TË
INVESTIMIT NË ENERGJINË
SOLARE NË KOSOVË

Autore
Diona Grezda

Balkan Green Foundation
Shkurt 2024 Prishtinë, Kosovë

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE

SHTJELLIMI I SFIDAVE TË INVESTIMIT NË ENERGJINË SOLARE NË KOSOVË



Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Balkan Green Foundation dhe ato nuk pasqyrojnë pikëpamjet e Kosovo Foundation for Open Society

AKRONIMET

AUK - Universiteti Amerikan i Kosovës

CAN - Rrjeti i Veprimit Klimatik

TKE - Traktati i Komunitetit të Energjisë / Komuniteti i Energjisë

BE - Bashkimi Evropian

SHA/BE - Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian

ZRRE - Zyra e Rregullatorit për Energji

IEA - Agjencia Ndërkombëtare për Energji

KEDS - Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë

KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike

kW - Kilovat

KWh - Kilovat-orë

MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

MW - Megavat

FV - Fotovoltaik

QEQ - Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri

BRE - Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë

PVKEQ - Plani i Veprimit për Klimë dhe Energji të Qëndrueshme

UBT - Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë

UP - Universiteti i Prishtinës

BP/BP6 - Ballkani Perëndimor/ Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor

PËRMBAJTJA

4 Shkurtesat

5 Përmbajtja

6 Përmbledhje ekzekutive

8 Hyrje

12 Shtjellimi i Sfidave të Investimit në Energjinë Solare në Kosovë

13 Procedurat e gjata dhe komplekse

16 Kufizimi i kapacitetit të instaluar të FV solare

17 Legalizimi

18 Afati kohor i gjatë i miratimit të Planit Zhvillimor Komunal

19 Periudha e gjatë e kthimit dhe çmimet e ulëta të energjisë elektrike

20 Skema mbështetëse modeste

21 Mungesa e mundësive për arsim dhe trajnime

22 Mungesa e vetëdijesimit publik

23 Rekomandime dhe përfundime

23 Të thjeshtësojë dhe të harmonizojë procedurat e lejeve

23 Të unifikojë dokumentet dhe të përditësojë planet ekzistuese zhvillimore

24 Të heqë barrën e lejes ndërtimore

24 Të ofrojë skema mbështetëse të bazuara në treg

25 Të krijojë një udhërrëfyes për zonat e investimeve në energji solare

25 Të diversifikojë burimet e veta të energjisë

25 Të investojë në bateri për deponim të energjisë

26 Të avancojë arsimimin dhe ngritjen e kapaciteteve për BRE

27 Të rrisë vetëdijesimin për përfitimet nga energjia solare

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova, si kandidate potenciale e Bashkimit Evropian (BE) dhe palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë (TKE), po i përfaqëson prioritetet klimatike dhe energjetike të BE-së, duke u përafëruar me ambicien përfundimtare për të qenë neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050. Në rrugën e saj drejt neutralitetit klimatik, Kosova ka caqe specifike që pritet t'i arrijë, ndër të cilat është edhe caku prej 32% i energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2030. Megjithatë, mbështetja e madhe në thëngjill në masën prej 77.69% po e bën rrugën e vendit drejt kalimit në burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE), dhe veçanërisht drejt paneleve fotovoltaike (FV) solare, sfiduese në shumë fronte.

Pavarësisht se gjeografikisht është në pozitë të përshtatshme për zhvillimin e energjisë solare, Kosova po përballet me pengesa ligjore, administrative dhe financiare siç janë procedurat e stërzgjatura të autorizimit, kufizimi i kapacitetit të instaluar të FV-ve solare, mungesa e aftësive dhe kapaciteteve të BRE-ve, procesi i stërzgjatur i legalizimit, mungesa e vetëdijesimit publik dhe skema mbështetëse modeste, të cilat po e përkeqësojnë barrën e investimeve në energjinë solare në vend.

Megjithatë, ka një rritje të interesit për teknologjinë solare pasi qytetarët dhe bizneset po bëhen gjithnjë e më të vetëdijshëm për përfitimet e tyre financiare dhe mjedisore. Në mars të vitit 2023, Kuvendi i Kosovës miratoi Strategjinë e Energjisë si një dokument të rëndësishëm për të udhëhequr tranzicionin energjetik të vendit për shtatë vitet e ardhshme. Në mesin e pesë prioriteteve kryesore qëndron qëllimi ambicioz për të rritur në mënyrë dinamike burimet e ripërtëritshme të energjisë, kryesisht ato të erës dhe diellit, i mbështetur nga ankandet e burimeve të ripërtëritshme, investimet publike dhe pjesëmarrja aktive e konsumatorëve vetëprodhues në këtë proces.

Megjithatë, Kosova duhet të intensifikojë punën e saj në drejtime të ndryshme për të arritur të shfrytëzojë sa më shumë potencialin e saj solar. FV-të solare ofrojnë një burim energjie me kosto efektive dhe të qëndrueshëm që po shfrytëzohet me të madhe në BE dhe më gjerë viteve të fundit. Pavarësisht koston së lartë të investimit fillestar, ky konsiderohet si një nga burimet më të lira të energjisë në dispozicion

për shkak të jetëgjatësisë së madhe të paneleve solare, koston së ulët të mirëmbajtjes, por edhe kontributit në uljen e faturave të energjisë dhe zvogëlimit të emetimeve. Pra, derisa rritja e përqindjes së burimeve të ripërtëritshme është një kërkesë ligjore për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me Acquis të BE-së për Energjinë, qytetarët e Kosovës dhe institucionet duhet ta shohin atë si një domosdoshmëri për mirëqenien e tyre dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Në këtë drejtim, kjo përmbledhje e politikave synon të hedhë dritë mbi sfidat që hasin konsumatorët në Kosovë gjatë investimeve në energjinë solare. Metodologjia e përdorur për këtë analizë është një kombinim i hulumtimit (dokumentet dhe publikimet zyrtare shtetërore, dokumentet dhe raportet e BE-së, raportet kërkimore, bazat e të dhënave statistikore, artikujt medial, etj.) dhe intervistat me palë të ndryshme të interesit (kompanitë solare, Komuna e Prishtinës, Zyra e Rregullatorit për Energji, ekspertë të energjisë etj.). Duke i bashkuar këto dy metoda, raporti përshkruan gjendjen aktuale të energjisë solare në Kosovë me fokus në sfidat dhe mundësitë.

HYRJE

Bashkimi Evropian (BE) ka filluar një rrugëtim transformues për t'u bërë kontinenti i parë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050, në kuadër të kornizës së Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane.¹ Në rrugën drejt neutralitetit klimatik, Shtetet Anëtare të BE-së (SHA/BE) janë zotuar që, deri në vitin 2030, të ulin emetimet neto të gazrave serrë për së paku 55% krahasuar me nivelet e vitit 1999.² Marrëveshja e Gjelbër përfshin nisma që mbulojnë klimën, mjedisin, energjinë, transportin, industrinë, bujqësinë dhe financimin e qëndrueshëm – të gjitha këto janë të ndërthurura fort dhe kontribuojnë në qëllimin përfundimtar klimatik.³

Ndërsa përkushtimi i BE-së për agjendën e gjelbër ka qenë evident për një kohë, mëngjesi i 24 shkurtit 2022 nxiti një ndjenjë të urgjencës dhe një përforsim të zotimit. Rritja e çmimeve të energjisë dhe shqetësimet urgjente për sigurinë energjetike kërkonin përpjekje më intensive nga BE dhe shtetet anëtare të saj për t'i dhënë fund varësisë së energjisë nga Rusia dhe për të përqafuar energjinë e gjelbër. Në maj të vitit 2022, BE-ja lansoi nismën “REPowerEU”, me energjinë solare si gur themeli, për të ndihmuar Shtetet Anëtare të kursejnë energjinë, të prodhojnë energji të pastër dhe të diversifikojnë furnizimet e tyre me energji.⁴ Tani, BE është e vendosur të rrisë cakun aktual prej ‘të paktën 32%’ të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në miksin e përgjithshëm të energjisë në të paktën 40% deri në vitin 2030, që do të thotë dyfishimin e pjesëmarrjes së BRE-ve në vetëm një dekadë.⁵

Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) si vende kandidatë dhe kandidatë potenciale për në BE, por edhe si Palë Kontraktuese të Traktatit të

1 Zbatimi i Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. 14 korrik 2021. https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/delivering-european-green-deal_en.

2 Ibid

3 Këshilli Evropian. Marrëveshja e Gjelbër Evropiane. <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/green-deal/#:~:text=European%20climate%20law&text=By%20adopting%20it%2C%20the%20EU,carried%20out%20by%20the%20Commission> Qasur më 19 shtator 2023

4 REPowerEU: Energji e përballueshme, e sigurt dhe e qëndrueshme për Evropën. 18 maj 2022. https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/repowereu-affordable-secure-and-sustainable-energy-europe_en

5 Komisioni paraqet Direktivën e rishikuar për Energjinë e Ripërtëritshme. https://commission.europa.eu/news/commission-presents-renewable-energy-directive-revision-2021-07-14_en Accessed 11 Oct. 2023.

Komunitetit të Energjisë (TKE) gjithashtu kanë përqafuar prioritetet e reja politike të BE-së dhe janë pajtuar me Deklaratën e Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor në nëntor të vitit 2020.⁶ Në këtë drejtim, gjashtë vendet nënshkruese janë përkushtuar për 'rritje të pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme për investime, në përputhje me acquis dhe cakun e BE-së dhe të Komunitetit të Energjisë'.⁷

Rajoni i Ballkanit Perëndimor (duke përfshirë Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Kosovën, Malin e Zi, Bosnje e Hercegovinën dhe Serbinë) është një zonë gjeografike e përshtatshme për zhvillimin e energjisë së gjelbër. Megjithatë, miksi energjetik i këtyre vendeve dominohet shumë nga thëngjilli (përveç Shqipërisë). Kjo varësi shkakton ndotje të lartë të ajrit dhe për pasojë çon në probleme shëndetësore dhe klimatike. Në vitin 2020, thëngjilli përbënte mbi 60% të burimit të prodhimit të energjisë elektrike bruto të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6).⁸ Megjithëse vendet e BP kanë marrë mbështetje të madhe financiare për tranzicionin e gjelbër,⁹ përpjekjet e tyre mbeten të vogla. Sipas Rrjetit të Veprimit Klimatik (CAN) të Evropës, mungesa e afateve kohore të qarta dhe e qartësisë së rrugëve specifike në Planin e Veprimit për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor kanë çuar në zbatim të kufizuar.¹⁰

Duke e parë Kosovën më nga afër, vendi prodhon rreth 77.69% të energjisë elektrike të saj nga thëngjilli.¹¹ Kjo varësi e madhe nga thëngjilli vë në pah domosdoshmërinë e dekarbonizimit si dhe investimin në teknologjitë e BRE. Si rezultat, rritja e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në miksin energjetik të Kosovës nuk është vetëm një kërkesë ligjore për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me Acquis të BE-së për Energjinë, por edhe një domosdoshmëri për mirëqenien e njerëzve. Sasia e ndotjes së ajrit e emetuar nga

6 Këshilli, Bashkëpunimi Rajonal. Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal | Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rrn> Qasur më 15 gusht 2023.

7 Ibid

8 Programi Rajonal - OBEZH-i dhe Evropa Juglindore. <https://t4.oecd.org/south-east-europe/programme/> Qasur më 19 shtator 2023.

9 Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor. Energjia e pastër. <https://www.wbfi.eu/sectors/energy> Qasur më 15 gusht . 2023.

10 CAN Europe. <https://caneurope.org/> Qasur më 10 gusht 2023.

11 Zyra e Rregullatorit për Energji. Raporti Vjetor 2022. Qasur më 20 nëntor 2023. Shih gjithashtu OBEZH. Rishikim shumëdimensional i Ballkanit Perëndimor: Nga analiza në veprim. OBZHE, 2022. DOI.org (Crossref), <https://doi.org/10.1787/8824c5db-en>

termocentralet e thëngjillit nga BP6 kontribuon çdo vit me rreth 3,900 vdekje të parakohshme, 8,500 raste të bronkitit të fëmijët dhe sëmundje të tjera kronike, të cilat shtojnë humbjen e produktivitetit dhe shpenzimet shëndetësore në shumën deri në 11.5 miliardë euro.¹²

Në përpjekje për të nxitur zhvillimin e kapaciteteve të BRE, veçanërisht në sektorin e energjisë elektrike, Kosova ka aplikuar skema mbështetëse si p.sh. tarifatat nxitëse (Feed-in) për disa vite.¹³ Tarifatat nxitëse janë ofruar mbi bazën “kush aplikon i pari, shërbehet i pari”, por janë bërë më pak të rëndësishme pasi vendet e BE-së kanë filluar të lëvizin drejt mekanizmave të promovimit të burimeve të ripërtëritshme që nxiten nga tregu.¹⁴ Në vitin 2020, Kosova iu afrua arritjes së cakut prej 25% me një pjesëmarrje prej 24,40% të burimeve të ripërtëritshme. Megjithatë, caku sektorial për ngrohje dhe ftohje është tejkaluar për shkak të përdorimit të burimeve të biomasës, ndërsa kontributi i energjisë së ripërtëritshme në energji elektrike dhe transport ishte ende shumë i ulët.¹⁵ Deri në fund të vitit 2021, Kosova ka regjistruar gjithsej 249.2 MW prodhim të energjisë elektrike të ripërtëritshme, 101 MW nga hidrocentralet e vogla, 137 MW nga era, 10 MW nga panelet solare si dhe 1.2 MW nga biomasa.¹⁶

Në mars të vitit 2023, Kuvendi i Kosovës miratoi Strategjinë e Energjisë 2022-2031, duke u zotuar për dekarbonizim të plotë të sektorit të energjisë.¹⁷ Kjo strategji paraqet një hap kyç në tranzicionin energjetik të Kosovës dhe fokusohet në pesë objektiva strategjike: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit; Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme; Rritja e eficiencës së energjisë; Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut; dhe Mbrojtja dhe fuqizimi i

12 “Aleanca për Shëndetin dhe Mjedisin | Ndotja kronike nga thëngjilli.” Aleanca për Shëndetin dhe Mjedisin. 18 janar 2023. <https://www.env-health.org/chronic-coal-pollution/>

13 DTGlobal. Vlerësimi i Gjeneratorëve FV në Kosovë Janar 2021. https://dt-global.com/projects/kess/Qasur_më_15_gusht_2023.

14 Lo, Chris. “Energjia e Ripërtëritshme: A po dalin jashtë mode tarifatat nxitëse?” Power Technology. 18 janar 2017. <https://www.power-technology.com/features/featurerenewable-energy-are-feed-in-tariffs-going-out-of-style-5718419/>

15 Komuniteti i Energjisë Raporti Vjetor i Zbatimit për Kosovën 1 nëntor 2022. https://www.energy-community.org/dam/jcr:dbe6d342-0ea7d-4677-9a9b-e18f22a1cfad/IR2022_Kosovo.pdf Qasur më 18 tetor 2023.

16 Komisioni Evropian Raporti për Kosovën 2022 <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf> Qasur më 3 tetor 2023.

17 Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://me.rks-gov.net/energja/> Qasur më 3 tetor 2023.

konsumatorëve.¹⁸

Përkritazi me energjinë e ripërtëritshme, Strategjia parasheh një rritje dinamike të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, kryesisht në teknologjitë e erës dhe ato fotovoltaike, të mbështetur nga ankandet e burimeve të ripërtëritshme, investimet publike dhe pjesëmarrja aktive e konsumatorëve vetëprodhues në këtë proces.¹⁹

Kosova ka rreth 240 ditë me diell në vit,²⁰ që përkthehet në potencial të madh në fushën e energjisë solare. Gjithashtu, Komisioni i BE-së konsideron se fotovoltaiket (FV) solare janë një nga burimet më të lira të energjisë elektrike në dispozicion, duke shtuar gjithashtu se “Panel pas paneli, energjia e pafund e diellit do të ndihmojë në uljen e varësisë tonë nga lëndët djegëse fosile në të gjithë sektorët e ekonomisë sonë, nga ngrohja e shtëpive deri te proceset industriale”.²¹ Ky burim energjie ofron një zgjidhje kosto-efektive dhe të qëndrueshme sepse energjia e prodhuar nga dielli është e pashtershme, zvogëlon emetimet dhe faturat e energjisë elektrike, por edhe për shkak të jetëgjatësisë së madhe të paneleve solare dhe kostonë së ulët të mirëmbajtjes së tyre.²² Në këtë drejtim, shfrytëzimi më i madh i BRE-ve – veçanërisht i FV-ve solare – do të jetë i dobishëm për Kosovën në tri nivele:

- Për të mbështetur zhvillimin e përgjithshëm ekonomik,
- Për të rritur sigurinë e furnizimit me energji, dhe
- Për të mbrojtur mjedisin.²³

Kjo përmbledhje e politikave fokusohet në energjinë solare si një nga burimet e ripërtëritshme të energjisë që janë shfrytëzuar me të madhe

18 Republika e Kosovës. Draft versioni i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2025-2030.

19 Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031. <https://me.rks-gov.net/energija/> Qasur më 3 tetor 2023.

20 Bizneset kosovare përfitojnë nga energjia e gjelbër me ndihmën e BE-së | EEAS. https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/kosovo-businesses-reaping-benefits-green-energy-help-eu_en?s=321 Qasur më 14 shtator 2023.

21 Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social të Rajoneve, Strategjia e BE-së për Energjinë Solare. 2022. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=COM%3A2022%3A221%3AFIN&qid=1653034500503>

22 “Përfitimet e sektorit rezidencial nga energjia elektrike e prodhuar nga sistemet solare.” Energy. Gov. <https://www.energy.gov/energysaver/benefits-residential-solar-electricity> Qasur më 20 dhjetor 2023.

23 DTGlobal. Vlerësimi i Gjeneratorëve FV në Kosovë Janar 2021. <https://dt-global.com/projects/kess/> AQasur më 15 gusht 2023.

në Evropë dhe më gjerë viteve të fundit. Përmes identifikimit të sfidave aktuale në Kosovë, ky raport synon të shërbejë si bazë për krijimin e një mjedisi më të favorshëm për investime në energji solare, nga thjeshtësimi i procedurave administrative deri te ofrimi i mbështetjes për investime të tilla në mënyra të ndryshme.

SHTJELLIMI I SFIDAVE TË INVESTIMIT NË ENERGINË SOLARE NË KOSOVË

Për t'u bërë konsumator vetëprodhues²⁴ në Kosovë nevojitet kycja në rrjetin e shpërndarjes apo transmisionit dhe një procedurë që përfshin tri institucione: komunën përkatëse, Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Kompaninë Kosovare për Distribim të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS), si dhe parashtrimin e rreth 15 dokumenteve të ndryshme.²⁵

Përderisa ky proces mund të duket i thjeshtë në shikim të parë, është një barrë e madhe për bizneset kosovare që kalojnë nëpër këto procedura së bashku me klientët e tyre në baza ditore. Kompanitë solare në Kosovë argumentojnë se procedurat e tilla që zgjasin nga 1 deri në 3 muaj, i dekurajojnë konsumatorët (rezidencialë ose afaristë) nga investimi në instalimet FV solare, veçanërisht kur iu shtohen edhe sfidat tjera si kufizimi i kapacitetit të instaluar të FV-ve solare që e zgjasin periudhën e kthimit.²⁶ Planet Zhvillimore Komunale, procesi i stërzgatur i legalizimit, dhe mungesa e aftësive dhe kapaciteteve për BRE janë faktorë shtesë që përkeqësojnë barrën e zhvillimeve solare në Kosovë. Megjithatë, pavarësisht nga pengesat, interesi për investime në energjinë solare është në rritje²⁷ dhe konsumatorët po bëhen gjithnjë e më të vetëdijshëm për përfitimet e tyre financiare dhe mjedisore. Mirëpo, për të shijuar përfitimet e tilla dhe për të përbushur detyrimet e saj ndaj BE-së dhe TKE-së, Kosova duhet të

24 Konsumatorët aktivë të energjisë shpesh quhen konsumatorë vetëprodhues sepse ata edhe konsumojnë edhe prodhojnë energji elektrike. Për më shumë shihni Energjia Elektrike. [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS_BRI\(2016\)593518](https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS_BRI(2016)593518) Qasur më 4 dhjetor 2023.

25 Ibid.

26 Intervistat e BGF-së me kompanitë e sistemeve solare në Kosovë, gusht 2023.

27 Ibid.

intensifikojë përpjekjet e saj në krijimin e një mjedisi më të favorshëm – në aspektin ligjor, administrativ dhe financiar – për investime në energjinë solare. Disa nga çështjet kryesore që meritojnë vëmendje në këtë drejtim janë:

PROCEDURAT E GJATA DHE KOMPLEKSE

Përkundër rekomandimit të Komunitetit të Energjisë për “thjeshtësimin dhe integrimin e procedurave të lejeve për të mundësuar zbatim më të shpejtë të burimeve të ripërtëritshme”, një nga sfidat kryesore që vazhdon të mbetet për investimet në energjinë solare në Kosovë është procedura e gjatë e autorizimit, nga autorizimi preliminar deri te ai përfundimtar.²⁸

Thënë shkurt, për të marrë statusin e Konsumatorit Vetëprodhues, konsumatorët e regjistruar të energjisë duhet të dorëzojnë kërkesën e tyre në ZRRE në formë të shkruar, në kopje fizike ose elektronike, që përmban këto dokumente:

- Konsumi vjetor i energjisë (lëshuar nga KESCO);
- Vlerësimi i prodhimit vjetor në kWh i vetëprodhuesit (kompania e sistemeve solare/shitësi);
- Marrëveshja për kyçje me operatorin e sistemit (KEDS); dhe
- Pëlqimi Komunal.²⁹


Pas autorizimit nga ZRRE-ja, konsumatorët e regjistruar të energjisë aplikojnë në KEDS për të marrë statusin e konsumatorit vetëprodhues ku nga ta pritet të dorëzojnë:

- Kërkesën për pëlqimin energjetik;
- Autorizimin e klientit për instaluesin/zhvilluesin e projektit;
- Licencën e kompanisë projektuese (profili energjetik) dhe diplomën e inxhinierit (zhvilluesit të projektit);

28 Komuniteti i Energjisë Raporti Vjetor i Zbatimit për Kosovën, 1 nëntor 2022. https://www.energy-community.org/dam/jcr:dbe6d342-ea7d-4677-9a9b-e18f22a1cfad/IR2022_Kosovo.pdf Qasar më 18 tetor 2023.

29 Zyra e Rregullatorit për Energji. Rregulli Nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të energjisë. 16 nëntor 2022.

RRJEDHA E PROCESIT TË APLIKIMIT PËR T'U BËRË PROSUMATOR



Burimi: KEDS

- Projektin elektrik (kapacitetin e kërkuar si konsumator vetëprodhues (kW), llojin e BRE, vlerësimin vjetor të prodhimit të energjisë së gjeneratorit (kWh), vlerësimin vjetor të energjisë së tepërt neto të furnizuar në rrjet).³⁰

Procedura mund të duket e thjeshtë nga ky këndvështrim, megjithatë, në realitet ajo zgjatë 1 deri në 3 muaj dhe përfshin komunën përkatëse, ZRRE-në dhe operatorin e shpërndarjes (KEDS), ku secili prej këtyre ka kërkesat dhe dokumentet e veta. Përveç kësaj, që të lëshohen disa nga dokumentet e mëposhtme nevojiten ndërveprime të ndërsjella ndërmjet institucioneve dhe klientit.³¹ Gjithashtu, konsumatorët nuk mund t'i dorëzojnë dokumentet e tyre në mënyrë elektronike në komunë apo KEDS, por këtë mund t'a bëjnë në ZRRE.

Sa i përket rolit të komunës përkatëse në këtë proces, duke e vendosur pëlqimin e saj si parakusht për autorizimin e instalimit të pajisjeve FV solare, ZRRE-ja i ka vështirësuar procedurat sipas kompanive solare dhe ekspertëve në Kosovë.³² Kjo i atribuohet mungesës së informacionit dhe konsensusit midis ZRRE-së dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) për dokumentin e saktë që do të kualifikohet si “pëlqim komunal”.

Për përfaqësuesit e ZRRE-së, mjafton një dokument i lëshuar nga inxhinierët e ndërtimit që konfirmon se pajisjet FV solare nuk i shkelin kodet e ndërtimit dhe standardet e sigurisë për marrjen e autorizimit, ndërsa unifikimi i dokumenteve bie në përgjegjësinë e MMPHI-së.³³ Në anën tjetër, nga pikëpamja e komunave, duke mos e specifikuar se çfarë pëlqimi komunal kërkon, ZRRE-ja ka krijuar paqartësi në procesin e aplikimit.³⁴ Aktualisht, çdo komunë e interpreton vetë këtë kërkesë dhe e krijon listën e saj të dokumenteve të kërkuara, duke e përkeqësuar edhe më tepër situatën për konsumatorët të cilët përfundojnë duke dorëzuar dokumentet e njëjta në të tri institucionet.³⁵

30 Konsumatori vetëprodhues. <http://www.keds-energy.com/eng/services/prosumer/> Qasur më 6 nëntor 2023.

31 Intervistat e BGF-së me kompanitë e sistemeve solare dhe ekspertët e energjisë në Kosovë, gusht 2023.

32 Intervistat e BGF-së me kompanitë e sistemeve solare dhe ekspertët e energjisë në Kosovë, gusht 2023.

33 Intervista e BGF-së me përfaqësuesit e Zyrës së Rregullatorit për Energji, 24 gusht 2023.

34 Intervista e BGF-së me zyrtarë të Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Urbanizmit, 29 gusht 2023.

35 Ibid.

Kompanitë e sistemeve solare janë përpjekur që ta lehtësojnë barrën e konsumatorëve duke i ndihmuar ata gjatë gjithë procesit të aplikimit, megjithatë, vetëm kjo nuk i nxit ata të investojnë në FV solare dhe nevojitet një thjeshtësim i procedurave.³⁶

KUFIZIMI I KAPACITETIT TË INSTALUAR TË FV SOLARE

Më 18 gusht 2023, Zyra e Rregullatorit për Energji miratoi Rregullin e ri për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtëritshme e cila dyfishon kufirin e kapacitetit solar për konsumatorët vetëprodhues të rregulluar nga 100 kW në 200 kW.³⁷ Sipas këtij rregulli të ri, konsumatorët familjarë të kyçur në rrjetin e tensionit të ulët (0,4 kW) nuk mund të instalojnë më shumë se 7 kW kapacitet të instaluar të fotovoltaikeve solar.³⁸ Konsumatorët jo-familjarë nga ana tjetër mund të instalojnë kapacitet deri në 200 kW në varësi të faktit se a janë të kyçur në rrjet të shpërndarjes me tension të ulët (0.4 kW) - pragu 100 kW ose me tension të mesëm (6kW, 10kW, 20kW dhe 35kW) dhe në sistem të transmisionit - pragu 200 kW.³⁹ Gjithashtu, kapaciteti i instaluar për çdo konsumator vendoset rast pas rasti në varësi të energjisë së konsumuar të tyre dhe të Pëlqimit Elektroenergjetik.⁴⁰

Përderisa rritja e kufizimit të kapacitetit të instaluar të FV solare shënon një hap vendimtar në evoluimin e shfrytëzimit të energjisë solare në Kosovë, kjo është megjithatë e pamjaftueshme, veçanërisht për konsumatorët industrialë dhe komercialë të mëdhenj. Kufizimet e tilla çojnë në një kthim të ngadalshëm të investimit – faktor ky që i bën investimet në teknologjitë solare më pak tërheqëse.⁴¹ Nga ana tjetër, shumica e Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë e kanë kufizuar kapacitetin e instaluar të konsumatorëve vetëprodhues me burime të ripërtëritshme në kapacitetin e kyçjes së konsumatorit fundor, duke e arsyetuar atë me nevojën për të ruajtur stabilitetin dhe besueshmërinë e sistemit elektro-energjetik.⁴²

36 Intervistat e BGF-së me kompanitë e sistemeve solare në Kosovë, gusht 2023.

37 Zyra e Rregullatorit për Energji. Rregulla Nr. 03/202 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtëritshme. 18 gusht 2023. Neni 5.

38 Po aty, Neni 5.

39 Po aty, Neni 5.

40 Po aty, Neni 5.

41 Intervistat e BGF-së me kompanitë e sistemeve solare në Kosovë, gusht 2023.

42 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. CBAM - Gjurmuesi i gatishmërisë 2023. Qershor 2023

Kufiri i kapacitetit të instaluar (kW)

	AMVISËRI	SUBJEKTE JURIDIKE
Shqipëri	500 kW	
Bosnje e Hercegovinë	10,8 kW	50 kW
Kosovë	200 kW	
Mali i Zi	pa kufi	
Maqedonia e Veriut	6 kW	40 kW
Serbi	10,8 kW	150 kW

Burimi: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, 2023

Nga perspektiva rajonale, Shqipëria dhe Mali i Zi prijnë në këtë aspekt: Shqipëria ka rritur kufirin e kapacitetit të instaluar të FV solare në 500 kW,⁴³ duke krijuar kështu kushte më të favorshme për projektet e energjisë solare, ndërsa Mali i Zi ka hequr kufizimin e kapacitetit për të nxitur instalimet solare në territorin e saj.⁴⁴

LEGALIZIMI

Leja ndërtimore është ndër dokumentet kryesore të nevojshme për marrjen e autorizimit për instalimin e një sistemi fotovoltaike në Kosovë.⁴⁵ Rrjedhimisht, nëse ndërtesa nuk legalizohet, panelet FV solare nuk mund të instalohen. Në anën tjetër, sipas Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, rreth 75% e objekteve në Kosovë janë pa leje ndërtimi.⁴⁶ Mbi të gjitha,

⁴³ Ibid.

⁴⁴ Ibid.

⁴⁵ DTGlobal. Vlerësimi i Gjeneratorëve FV në Kosovë Janar 2021 <https://dt-global.com/projects/kess/> Qasur më 15 gusht 2023.

⁴⁶ Aliu i Bindur Se 75% e Ndërtimeve Në Kosovë Janë Pa Leje | Ministri i Mjedisit, Planifikimit

procesi i legalizimit po ecë ngadalë, duke penguar kështu shumë zhvillime në Kosovë, duke përfshirë edhe investimet në energjinë solare.⁴⁷

Më 5 shtator 2023, MMPHI bëri hapin e parë për tejkalimin e pengesës së legalizimit për konsumatorët vetëprodhues duke e ndryshuar Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 08/2013 për ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimore.⁴⁸ Përmes këtij ndryshimi, instalimi i paneleve FV solare në kulme (për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum) për amvisëritë me kapacitet të instaluar deri në 7 kW mund të bëhet pa leje ndërtimore.⁴⁹

Megjithatë, legalizimi mbetet pengesë për kategoritë tjera të konsumatorëve, me kapacitet të instaluar prej më shumë se 7 kW, për të cilat Kosova duhet të punojë më tej për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme. Ky është një aspekt i rëndësishëm, veçanërisht kur kujtojmë faktin se nga Kosova pritet të jetë në pajtueshmëri me Acquis të BE-së për Energjinë dhe të rrisë pjesëmarrjen e saj të burimeve të ripërtëritshme deri në vitin 2030 – një cak ky i përforcuar veçanërisht pas krizës së fundit energjetike. Përveç kësaj, nga Kosova pritet “thjeshtësimi dhe integrimi i procedurave të lejeve” për sa i përket zgjidhjeve të energjisë së ripërtëritshme.

AFATI KOHOR I GJATË I MIRATIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

Plani Zhvillimor Komunal është një dokument strategjik që parasheh zhvillimin e komunës për 8 vitet e ardhshme. Një dokument i tillë luan një rol vendimtar në procesin e investimeve në energjinë solare, veçanërisht në vitet e fundit kur interesi për investime në energji solare është rritur. Megjithatë, duke pasur parasysh se Planet Zhvillimore Komunale miratohen një herë në 8 vjet, të gjithë investitorët potencialë duhet të presin që plani aktual zhvillimor komunal të skadojë që të

Hapësinor Dhe Infrastrukturës Liburn Aliu Në Seancën e Kuvendit... EkonomiaOnline. Facebook. <https://www.facebook.com/EkonomiaOnline/videos/aliu-i-bindur-se-75-endor%C3%ABrtimeve-n%C3%AB-kosov%C3%AB-jan%C3%AB-pa-leje/4058719957685768/> Qasur më 6 nëntor 2023

47 Intervistat e BGF-së me një kompani të sistemeve solare dhe ekspertët e energjisë në Kosovë, gusht 2023.

48 Udhëzim Administrativ MMPHI Nr.15/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ MMPH Nr. 08/2013 për ndërtimet për të cilat nuk kërkohet leje ndërtimore. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=80969>. Qasur më 11 tetor 2023.

49 Ibid.

mund të vazhdojnë me procedurat e investimit.⁵⁰ Sipas “Telegrafi”, në vitin 2023, të paktën 20 kompani kanë aplikuar në KOSTT për t’iu ofruar zgjidhje teknike për kyçjen e sistemeve solare në rrjet.⁵¹

Pra, ky miratim periodik i planit zhvillimor komunal paraqet pengesë për forma të ndryshme të investimeve komunale, duke përfshirë edhe pajisjet solare.

PERIUDHA E GJATË E KTHIMIT DHE ÇMIMET E ULËTA TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Konsumatorët e familjarë dhe ata jo familjarë të cilët janë të kyçur në rrjet të tensionit të ulët (0.4 kW) ose të mesëm (6kW, 10kW, 20kW dhe 35kW) dekurajohen nga investimi në FV solare për shkak të kthimit të ngadaltë të investimit që e përjetojnë si rezultat i ngarkesave aktuale administrative, teknike dhe legjislative si dhe çmimeve të ulëta të energjisë elektrike në Kosovë. Megjithatë, realiteti po ndryshon shpejt – veçanërisht pas krizës së fundit energjetike – dhe lëndët djegëse fosile po shtrenjtohen kurse burimet e ripërtëritshme vazhdojnë të lirohen çdo vit.⁵² Përveç kësaj, në vitin 2021, IRENA raportoi se dy të tretat e energjisë së ripërtëritshme të instaluar kohëve të fundit në vendet e G20 kishin kosto më të ulëta sesa opsioni më i lirë me lëndë djegëse fosile – dhe ato do të bëhen gjithnjë e më të përbalueshme.⁵³

Sipas një kompanie të sistemeve solare në Kosovë, kostoja mesatare aktuale për FV solare për kW është 400-450 EUR.⁵⁴ Duke e rritur kufirin e kapacitetit të instaluar ose duke i harmonizuar procedurat, vendi mund të zvogëlojë periudhën e kthimit, duke ndikuar kështu pozitivisht në zhvillimin e energjisë solare në Kosovë.⁵⁵ Megjithatë, ka nisma të tjera që Qeveria mund t’i ndërmarrë, siç janë ofrimi i skemave mbështetëse apo edhe vetëm rritja e vetëdijesimit për përfitimet afatgjata nga teknologjitë solare.

50 “Shteti po bllokoi qindra miliona euro investime në energji solare.” Telegrafi, 3 Aug. 2023, <https://telegrafi.com/shteti-po-blokon-qindra-miliona-euro-investime-ne-energji-solare/>

51 Ibid.

52 “A është energjia e ripërtëritshme më e lirë se lëndët djegëse fosile? | Eco Experts.” The Eco Experts, <https://www.theecoexperts.co.uk/blog/is-renewable-energy-cheaper-than-fossil-fuels> Aqasar më 15 dhjetor 2023.

53 Ibid.

54 Korrespondenca e BGF-së me një kompani të sistemeve solare në Kosovë, 15 gusht 2023.

55 Ibid.

SKEMA MBËSHTETËSE MODESTE

Kosova ka prezantuar tarifat nxitëse (feed-in) në vitin 2016 si një mjet për të mbështetur zhvillimin e energjisë së pastër, të cilat janë ofruar mbi bazën “kush aplikon i pari, shërbehet i pari”.⁵⁶ Nëpërmjet një mekanizmi të tillë, prodhuesve të energjisë së ripërtëritshme u jepet një çmim i garantuar mbi çmimin e tregut për energjinë elektrike që ata e furnizojnë në rrjet. Ky mekanizëm ishte propozuar nga Banka Botërore në vitin 2011 duke pasur parasysh se Kosova ishte një treg i vogël dhe teknologjitë e BRE nuk ishin konkurruese në atë kohë.⁵⁷ Megjithatë, prodhuesit nuk kanë mundur t'i gëzojnë përfitimet e kësaj mase për një kohë të gjatë pasi në dhjetor të vitit 2020 ZRRE-ja vendosi ta shfuqizojë regjimin e tarifave nxitëse (feed-in) duke mos lënë në fuqi asnjë mekanizëm të përcaktimit të çmimit për projektet e reja.⁵⁸

Kohëve të fundit, sektorët e energjisë së ripërtëritshme në vendet e Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë kanë qenë dëshmitarë të një tranzicioni nga tarifat nxitëse të përcaktuara në mënyrë administrative në skema mbështetëse të bazuara në treg.⁵⁹ Tranzicioni drejt mbështetjes së burimeve të ripërtëritshme të bazuara në treg në Evropë është një qëllim i Komisionit Evropian i nxitur nga çmimet e larta të energjisë elektrike për konsumatorë, i shoqëruar me mosbalancimin e mundshëm të furnizimit me energji të ripërtëritshme të mbështetur me tarifa nxitëse dhe nevojat aktuale të rrjeteve kombëtare dhe ndërkufitare.⁶⁰

Në këtë drejtim, prezantimi i ankandëve po paraqitet si një element kryesor në legjislacionin për energjinë e ripërtëritshme të Ballkanit Perëndimor.⁶¹ Në rastin e Kosovës, raundi fillestar i ofertave për ankandin e energjisë solare është vonuar tri herë deri më tani, duke

56 INDEP. Tarifat nxitëse dhe rëndësia e tyre për investime në Kosovë. 2014.

57 Energjia, Kosovë. “Ekspertë Të Sektorit Të Energjisë Diskutojnë Skemat Mbështetëse Për Projekte Të Energjisë, Kritikojnë Paqartësinë Rreth ‘Kosova e Re.’” Kosovo.Energy, 2 korrik 2021, <https://kosovo.energy/eksperte-te-sektorit-te-energjisie-diskutojne-skemat-mbeshtetese-per-projekte-te-energjisje-kritikojne-paqartesine-rreth-kosova-e-re/>

58 DTGlobal. Vlerësimi i Gjeneratorëve FV në Kosovë Janar 2021. [https://dt-global.com/projects/kess/ Qasur më 15 gusht 2023.](https://dt-global.com/projects/kess/Qasur%20m%C3%AB%2015%20gusht%202023)

59 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. CBAM - Gjurmuesi i gatishmërisë 2023. Qershor 2023

60 Lo, Chris. “Energjia e Ripërtëritshme: A po dalin jashtë mode tarifat nxitëse?” Power Technology. 18 janar 2017. <https://www.power-technology.com/features/featurerenewable-energy-are-feed-in-tariffs-going-out-of-style-5718419/>

61 Ibid.

u zhvendosur nga data fillestare e 15 gushtit 2023 (në 3 shtator, 16 tetor 2023) në 31 janar 2024.⁶² Ministria e Ekonomisë deklaroi se afati i ankandit për energji solare është shtyrë me kërkesë të kompanive të interesuara që të plotësojnë dokumentacionin përkatës për pjesëmarrje në ankand.⁶³ INDEP, nga ana tjetër, kritikoi vonesat duke shtuar se ato mund të rrezikojnë dinamikën e zbatimit të Strategjisë së Energjisë dhe do të dobësojnë rëndësinë e kësaj nisme.⁶⁴ Nëse do të vazhdojë ky trend i vonesave, kjo do të ndikojë në zbatimin e përgjithshëm të masës si dhe në qëllimin e saj.

MUNGESA E MUNDËSIVE PËR ARSIM DHE TRAJNIM

Për sa i përket energjisë së ripërtëritshme, apo më konkretisht arsimimit dhe ngritjes së kapaciteteve për energjinë solare, situata nuk qëndron më mirë. Sipas të dhënave të janarit 2021, vetëm Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës (UP) dhe Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë (UBT) ofrojnë programe studimi për BRE në Kosovë.⁶⁵ Universiteti Amerikan i Kosovës (AUK) dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të UP-së ofrojnë vetëm module për BRE ndërsa Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri (QEQ)⁶⁶ ofron kurse të certifikuara në BRE duke përfshirë energjinë solare.

Përveç programeve të kufizuara në BRE që ofrojnë universitetet, mungojnë edhe mundësitë për të kryer praktikën, programet e shkëmbimit apo trajnimet (për studentët dhe stafin akademik) që mund të plotësojnë boshllëqet duke rritur aftësitë praktike në këtë fushë. Në këtë drejtim, kompanitë e energjisë solare ankohen për mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar, veçanërisht teknikëve.⁶⁷ Kur bëhet fjalë për shkollat e mesme, nuk i kushtohet shumë vëmendje

62 Energjia, Kosovë. "Shtyhet Sërish Afati Për Ankandin Solar, Reagojnë Nga INDEP." Kosovo.Energy, 18 tetor 2023, <https://kosovo.energy/shtyhet-serish-afati-per-ankandin-solar-reagojne-nga-indep/>

63 Luljeta Krasniqi-Veseli. "'Sinjale të këqija' për investitorët në energji të ripërtëritshme." Radio Evropa e Lirë, 10 nëntor 2023. www.evropaelire.org, <https://www.evropaelire.org/a/energia-e-riperterishme-investitoret-kosove-/32679636.html>.

64 Energjia, Kosovë. "Shtyhet Sërish Afati Për Ankandin Solar, Reagojnë Nga INDEP." Kosovo.Energy, 18 tetor 2023, <https://kosovo.energy/shtyhet-serish-afati-per-ankandin-solar-reagojne-nga-indep/>

65 DTGlobal. Vlerësimi i Gjeneratorëve FV në Kosovë Janar 2021 <https://dt-global.com/projects/kess/Qasur> më 15 gusht 2023.

66 Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri e Universitetit të Prishtinës është themeluar në tetor 2017 me mbështetjen e USAID-it dhe Universitetit Shtetëror të Arizonës. Kjo Qendër ofron programe të certifikuara në "energjinë e ripërtëritshme dhe qëndrueshmërinë" dhe lidh anëtarët e fakultetit nga të gjitha disiplinat akademike në Universitetin e Prishtinës me akademikë nga universitetet nga e mbarë bota.

67 Intervistat e BGF-së me një kompani të sistemeve solare në Kosovë, 16 gusht 2023.

energjisë së ripërtëritshme dhe potencialit të saj, që dëshmohej nga mungesa e plan-programeve të përditësuara në fushën e energjisë.⁶⁸ Për më tepër, mungojnë hapësirat e dedikuara për studentët për të zhvilluar aftësitë praktike në pajisjet e BRE brenda institucioneve arsimore. Një tjetër aspekt sfidues në sektorin e arsimit për energjinë dhe në tregun e punës në sektorin elektro-energjetik janë pabarazitë dhe boshllëqet gjinore.⁶⁹ Të gjitha këto aspekte kontribuojnë në mungesën e përgjithshme të fuqisë punëtore të aftë në fushën e energjisë së ripërtëritshme.

MUNGESA E VETËDIJESIMIT PUBLIK

Në nivelin e popullsisë, ka mungesë të vetëdijesimit në lidhje me pasojat mjedisore të lëndëve djegëse fosile dhe përfitimet e zgjidhjeve të energjisë së ripërtëritshme. Duke u fokusuar në panele fotovoltaike solare, qytetarët në Kosovë nuk janë të informuar mirë për kostot e tyre dhe kthimin e investimit. Prandaj, është e nevojshme t'i informojmë ata, për shembull, se energjia solare është bërë burimi më i lirë i energjisë elektrike në histori, sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (IEA).⁷⁰ Kjo i atribuohet shumë faktorëve ndër të cilët edhe faktit që energjia solare kontribuon në uljen e faturave të energjisë si dhe në uljen e emetimeve. Gjithashtu, shumë pak kanë njohuri për pavarësinë energjetike dhe sigurinë e furnizimit të ofruar, si dhe ndikimin e përgjithshëm që ka energjia solare në mjedis.

Pra, ekziston një nevojë urgjente për të informuar publikun e gjerë për përfitimet e investimit në energji të ripërtëritshme, veçanërisht në FV solare.

68 DTGlobal. Vlerësimi i Gjeneratorëve FV në Kosovë Janar 2021 <https://dt-global.com/projects/kess/> Qasur më 15 gusht 2023.

69 Ibid.

70 Fiestas, Pierina. "Si u bë energjia solare 'burimi më i lirë i energjisë në histori'?" WTS Energy, 17 prill 2023, <https://www.wtsenergy.com/solar-cheapest-energy-source-in-history-factor/>

REKOMANDIME DHE PËRFUNDIME

Kosova ka potencial të lartë për zhvillimin e energjisë solare me rreth 240 ditë me diell në vit. Vendimi për të investuar në energji solare, megjithatë, nuk duhet të mbështetet vetëm në faktorët gjeografikë por edhe në aspektet financiare dhe mjedisore: energjia solare konsiderohet si një nga burimet e energjisë më kosto-efektive në ditët e sotme dhe ka një rol të rëndësishëm në zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike.

Prandaj, duke njohur nevojën urgjente për burime alternative të energjisë si dhe ndikimin e zhvillimit të energjisë solare në sigurinë e saj energjetike, në zhvillimin ekonomik dhe në mbrojtjen e mjedisit, Kosova duhet të angazhohet për shfrytëzim më të madh të këtij burimi të energjisë.

Megjithatë, për të shijuar vërtet përfitimet e energjisë solare dhe për të rritur investimet, vendi duhet:

TË THJESHTËSOJË DHE TË HARMONIZOJË PROCEDURAT E LEJEVE

ZRRE-ja duhet të punojë në thjeshtësimin e procedurave të lejeve për instalimet FV solare. Kjo mund të arrihet duke eliminuar disa kufizime, duke zvogëluar numrin e dokumenteve të kërkuara, duke shkurtuar kohëzgjatjen e procedurës së autorizimit dhe duke rritur efikasitetin e institucioneve të përfshira. Kosova, duke krijuar dhe funksionalizuar një “one-stop shop” për dorëzimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme, siguron një proces të përshtatshëm të autorizimit pasi lehtëson barrën e konsumatorëve dhe institucioneve. Krijimi i një “one-stop-shop” nënkupton edhe zvogëlimin e kohëzgjatjes për autorizim dhe vëllimin e dokumenteve.

TË UNIFIKOJË DOKUMENTET DHE TË PËRDITËSOJË PLANET EKZISTUESE ZHVILLIMORE

MMPHI-ja duhet të punojë për konsolidimin e dokumenteve të nevojshme për marrjen e pëlqimit komunal për instalimet FV solare. Unifikimi i dokumenteve duhet të mbështetet nga ZRRE-ja, ku të dyja

palët arrijnë një konsensus për një dokument të standardizuar që do të lëshohet nga të gjitha komunat. Ky dokument, i cili do të lëshohet me emërtimin “Pëlqim Komunal”, do të sigurojë që instalimi të respektojë kodet e ndërtimit dhe standardet e sigurisë.

Gjithashtu, në mënyrë që të adresojnë në mënyrë të duhur interesin e shtuar të investitorëve potencialë për FV solare dhe burime të tjera të ripërtëritshme, komunat duhet të gjejnë një zgjidhje për të shmangur periudhën aktuale të gjatë të miratimit të planeve zhvillimore. Në këtë drejtim, komunat në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse mund të pajtohen që të zgjerojnë fushëveprimin e Planit aktual Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, i cili sipas Ligjit nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë përgatitet nga komunat për 3 vjet.⁷¹ Për më tepër, planet e tilla do të ishin mjaft të ngjashme me Planin e Veprimit për Klimë dhe Energji të Qëndrueshme (PVKEQ), i cili është dokument kyç për komunat që të anëtarësohen në Konventën e Kryetarëve të Komunave - një lëvizje evropiane e bashkëpunimit që përfshin autoritetet lokale dhe rajonale - ku aktualisht, vetëm dy komuna (Gjilani dhe Podujeva) janë anëtare.⁷²

TË HEQË BARRËN E LEJES NDËRTIMORE

75% e ndërtesave në Kosovë janë pa leje ndërtimore, megjithatë ato janë të kyçura në rrjetin e energjisë elektrike, të ujit dhe të mbledhjes së mbeturinave. Për sa i përket standardeve të sigurisë dhe kodeve të ndërtimit, përfaqësuesit e ZRRE-së kërkojnë vetëm një dokument të lëshuar nga inxhinierët e ndërtimit që konfirmon respektimin e këtyre standardeve nga pajisjet FV solare. Përveç kësaj, MMPHI tashmë e ka hequr barrën e lejes ndërtimore për konsumatorë familjarë me kapacitet të instaluar deri në 7 kW të paneleve FV solare. Duke marrë parasysh të gjitha këto aspekte, MMPHI duhet përdorë si model vendimin e saj të 5 shtatorit dhe të heqë pengesën e lejes ndërtimore për të gjitha kategoritë përtej atyre për konsum familjar me kapacitet të instaluar deri në 7 KW të paneleve FV solare.

TË OFROJË SKEMA MBËSHTETËSE TË BAZUARA NË TREG

Kosova duhet të shmangë vonesat e mëtejshme në procesin e ankandeve, të cilat vetëm sa do ta rrezikojnë efektivitetin e këtij mekanizmi. Paralelisht, vendi duhet të ofrojë skema të tjera

⁷¹ Republika e Kosovës, Ligji për Eficiencën e Energjisë Nr. 06/L-079.

⁷² Ibid.

mbështetëse të bazuara në treg me qëllim që t'i mbështes investimet në energjinë e ripërtëritshme.

TË KRIJOJË NJË UDHËRRËFYES PËR ZONAT E INVESTIMEVE NË ENERGJI SOLARE

Institucionet përkatëse shtetërore, me mbështetjen e akterëve ndërkombëtarë, janë duke krijuar një udhërrëfyes për zonat e investimeve në energjinë solare në territorin e Kosovës. Ndërsa procesi është duke u zhvilluar, është shumë e rëndësishme të intensifikohet puna për finalizimin dhe funksionalizimin e këtij udhërrëfyesi, duke pasur parasysh miratimin periodik të Planeve Zhvillimore Komunale dhe faktin se i njëjti po pengon investimet e mundshme në energji solare nga investitorët vendas apo të huaj. Duke i identifikuar të gjithë zonat brenda territorit që janë të përshtatshme për investime në energji solare, Kosova do t'u ofrojë investitorëve potencialë një hartë të zonave ku mund të zhvillohet energjia solare në mënyrë që ata të mund të planifikojnë investimet e tyre në mënyrë të duhur.

TË DIVERSIFIKOJË BURIMET E VETA TË ENERGJISË

Kosova duhet të fokusohet në diversifikimin e burimeve të saj të energjisë përtej energjisë solare në mënyrë që të rrisë sigurinë energjetike dhe qëndrueshmërinë. Përveç kësaj, duke investuar në një gamë më të gjerë të teknologjive energjetike, Kosova do të sigurojë më shpejt pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e saj energjetike përmes rritjes së disponueshmërisë së burimeve të energjisë (diellore, hidro, erë, biomasa).

TË INVESTOJË NË BATERI PËR DEPONIM TË ENERGJISË

Investimi në bateri për deponimin e energjisë është një zgjidhje e kushtueshme por e pashmangshme për Kosovën nëse synon të rrisë pjesëmarrjen e saj të burimeve të ripërtëritshme – veçanërisht të energjisë nga era dhe dielli – dhe të përmbushë caqet e dekarbonizimit të vitit 2050. Përveç kësaj, investimi në kapacitete të deponimit do të kontribuonte në sigurinë e furnizimit.

Sipas një analize të koston, të realizuar në vitin 2018 në rajon, një projekt i madh që kombinon energjinë e erës dhe atë solare me deponimin e energjisë në bateri mund të arrihet me një kosto më të ulët sesa prodhimi i energjisë elektrike nga linjiti.⁷³

73 Për më shumë, shih Institutin për Ekonomi të Energjisë dhe Analizë Financiare, Përtej Qymyrit:

TË AVANCOJË ARSIMIMIN DHE NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR BRE

Duke e njohur rëndësinë e teknologjive të ripërtëritshme në rrugën e tranzicionit energjetik të vendeve, Kosova duhet të fokusohet në rritjen e mundësive për arsimim dhe trajnim në këtë fushë. Kjo mund të bëhet duke e rritur numrin e programeve në universitetet shtetërore dhe ato private të hartuara në fushën e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, me theks të veçantë në energjinë solare, duke ofruar orientim karriere në BRE dhe rëndësinë e këtyre burimeve në ditët e sotme, duke ofruar trajnime për aftësi praktike në teknologjitë dhe pajisjet e BRE-ve, duke i rihartuar kurrikulat e shkollave të mesme në atë mënyrë që të përfshijnë arsimimin në BRE, duke e forcuar Qendrën për Energjinë dhe Qëndrueshmërinë, duke ofruar trajnime për mësimdhënësit dhe profesorët, duke ofruar programe të punës praktike, shkëmbimi dhe mentorimi për studentët, duke krijuar hapësira të dedikuara brenda institucioneve arsimore për demonstrimin e aftësive praktike në BRE, etj. Në këtë drejtim, zhvillimi i programeve specifike të trajnimit për studentë bazuar në marrëveshjet ndërmjet kompanive përkatëse dhe UP-së mund të rezultojë në përmirësim thelbësor të aftësive praktike të të diplomuarve të ardhshëm në fushat e inxhinierisë.⁷⁴ Bordet industriale ekzistuese tashmë brenda fakulteteve teknike të Universitetit të Prishtinës mund të shfrytëzohen gjithashtu për të siguruar kontakte dhe për të zhvilluar plan-programin e këtyre programeve të trajnimit.⁷⁵

Përveç kësaj, Qeveria dhe Universiteti duhet të punojnë së bashku për të hartuar dhe organizuar trajnime në vendin e punës për profesionistët dhe instaluesit që kanë një përvojë të caktuar pune në këtë fushë. Një shembull i mirë është krijuar nga Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri, e cila që nga viti 2020 ka ofruar me sukses certifikimin e Auditorëve të Energjisë.⁷⁶

Në fund, theksi duhet të vihet edhe në mbushjen e hendekut gjinor në mundësitë e arsimimit në energji, si dhe në tregun e punës për të garantuar gjithëpërfshirje dhe barazi.

Investimi në të ardhmen
Energjetike të Kosovës, tetor 2020.

74 Intervista e BGF-së me një profesor/ekspert të energjisë, Universiteti i Prishtinës, dhjetor 2023.

75 Ibid.

76 Ibid.

TË RRIË VETËDIJËSIMIN PËR PËRFITIMET NGA ENERGJIA SOLARE

Rritja e vetëdijësimit është me rëndësi thelbësore për të nxitur zhvillimin e energjisë solare në vend. Rritja e vetëdijësimit duhet të ndodhë në nivel social përmes organizatave të shoqërisë civile, institucioneve shtetërore, partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtarë, bizneseve dhe akademisë. Përmes kultivimit të vetëdijësimit të qytetarëve për përfitimet nga teknologjitë solare, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, uljen e faturave të energjisë, pavarësinë energjetike, rritjen e sigurisë së furnizimit, mbrojtjen e mjedisit, etj., ne mund të rrisim interesin e tyre për të adoptuar zgjidhje të tilla inovative.

